

## **“ose institucionet” – Apo, si po legalizohet një vjedhje industriale e pasurisë së OJQ-ve në Kosovë?**

Nga: Taulant Hoxha

*Ky shkrim është botuar në Koha Ditore të datës 19 janar 2018.*

Ligji për OJQ i miratuar në nëntor 2018 nga Kuvendi i Kosovës e shkatërron themelin e sektorit jo-qeveritar e të shoqërisë civile. Ky ligj e legalizon mundësinë që pasuria e OJQ-ve të tjetërsohet dhe t’i kalojë edhe institucioneve private, duke hapur rrugë për praktika korruptive dhe keqpërdorim të qindra miliona eurove, tani dhe në të ardhmen. Një ligj i tillë është i paprecedent në Europë dhe më gjerë.

Me kthimin e ligjit në Kuvend pas kërkesës së shoqërisë civile, deputetët tani e kanë mundësinë që ta parandalojnë një keqpërdorim masiv, duke i votuar amendamentet e propozuara nga shoqëria civile. Për t’a bërë këtë, tashmë kërkohet vota e të paktën 61 deputetëve të Kuvendit të Kosovës gjatë leximit të tretë që pritet të ndodhë ditëve në vazhdim.

Kur më 7 nëntor po votohej Ligji për OJQ, Kryetari i Komisionit për Administratë Publike fliste se si disa banka janë organizata joqeveritare (sic) e që kanë të hyra me miliona e miliona, me 70 milionë euro para të gatshme e 150 milionë kredit, që i kanë krijuar në kurriz të qytetarëve të cilët kanë marrë para me kamata deri në 38%. Kushdo që nuk është ekspert i fushës, deklarime të tilla do t’i vlerësonte si mbrojtje të interesit publik dhe qytetarëve nga disa OJQ mikrofinanciare problematike. Por çka kishte ndodhur në të vërtetë dhe çka po u ofrohej deputetëve për votim ishte komplet e kundërta e këtij deklarimi. Një ndryshim i vogël në dukje, por shumë i madh në përmbajtje dhe pasoja. Vetëm disa ditë më parë, larg syve të publikut Komisioni i udhëhequr nga z. Hasani kishte shtuar fjalët “ose institucionet” në nenin i cili përcaktonte se kush mund të ishte trashëgimtar i pasurisë së një OJQ-je që shuhet. Me këtë, bëhej i ligjshëm keqpërdorimi më i madh që mund të bëhet me sektorin jo qeveritar.

Në Kosovë, nga viti 1999 kur u hartua Rregullorja e parë për OJQ, ekzistonte dispozita që asnjë pasuri e OJQ-së nuk mund të shfrytëzohet për përfitime private, por vetëm për të përmbushur misionin e organizatës. Rrjedhimisht edhe dispozita që kur një OJQ shuhet, pasuria që mbetet i kalon një OJQ-je me mision të njejtë ose të ngjashëm. Normalisht, ky parim e këto dispozita nuk ishin zbulim i Kosovës, por vetëm normim i parimit themelor dhe univerzal të sektorit, parimit jo për përfitim. Aq themelor është ky parim, saqë praktika ndërkombëtare dhe shumica e vendeve gjithandej botës vet sektorin joqeveritar e quajnë sektor jo për përfitim, ndërsa dispozitat ligjore që e normojnë këtë janë gati se identike gjithandej. Nga 7 nëntori 2018, kur deputetët votuan atë që ju prezantohej si mbrojtje e interesit publik dhe qytetarëve, “ose institucionet” nënkuptonte që kur një OJQ shuhet, trashëgimtar i pasurisë së mbetur mund të jenë OJQ-të OSE INSTITUCIONET (përfshirë ato private).

Në vitin 2013, një tentim i ngjashëm por shumë më i kufizuar për nga pasojat ishte parandaluar nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese, për Ligjin për banka dhe institucione mikrofinanciare, poashtu pas reagimit të shoqërisë civile. Në atë aktgjykim qartë ishte konfirmuar që pasuria e OJQ-ve nuk guxon të kalojë në biznese private, por të mbesë në sektor. Me këtë, (do të duhej të) kishte marrë fund tentimi i kahmotshëm i OJQve mikrofinanciare që kapitalin e grumbulluar në emër të interesit publik ta transferojnë në biznese private.

Dhjetra miliona euro janë dhënë si donacione për OJQ-të në Kosovë nga donatorë të huaj e vendorë, për fusha nga më të ndryshmet. Nga të drejtat e fëmijëve te mbrojtja e ambientit. Nga strehimoret e viktimave të dhunës te lufta kundër korrupsionit. Nga kultura te trajnimi i bujqve, dhe cilado sferë e

jetës shoqërore në Kosovë. Janë dhënë me garancionin që këto donacione nuk do të kalojnë në xhepa privatë. Janë dhënë me garancionin që nëse megjithatë dikush ndonjë pjesë të pasurisë së OJQ-ve e keqpërdor për interesa private, kjo do të jetë e jashtëligjshme, pra do të ndiqet nga organet kompetente. Ashtu siç ndodh në çdo vend tjetër, ku jepen qindra miliona e madje miliarda euro për këtë sektor. Por nuk janë dhënë për ta konsideruar këtë keqpërdorim të ligjshëm. Dhe nuk do të vazhdojnë të jepen në të ardhmen, poqëse ky keqpërdorim mbetet i ligjshëm.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës tashmë janë të informuar detajisht për pasojat, dhe fatmirësisht kanë një mundësi të fundit t'i parandalojnë ato. Por çfarë ndodh nëse, megjithatë vendosin të mos marrin përgjegjësinë e tyre kushtetuese në mbrojtje të interesit publik, pra të mos votojnë pro rikthimit të dispozitave standarde? Asgjë më shumë sesa transferim i atyre 150-200 milion eurove të OJQ-ve mikrofinanciare, të cilat përmenden nga z. Hasani, në xhepa privat, në mënyrë të ligjshme. Asgjë më shumë sesa mundësi që secila OJQ që ka një kapital, objekt, para të gatshme apo çfarëdo pasurie tjetër, të mund ta bëjë të njëjtën kurdo që e sheh të arsyeshme, në mënyrë të ligjshme. Asgjë më shumë sesa mundësi që çdo grant qeveritar, apo nga donatorët tjerë të huaj apo vendor, që jepet për OJQ ta ketë rrugën e ligjshme për t'u transferuar te bizneset private. Asgjë më shumë sesa mungesë e sigurisë më të vogël juridike për donatorët që të vazhdojnë të japin fonde për sektorin. Asgjë më shumë sesa rrezikim i vet ekzistencës së sektorit.

Për këtë arsye, votimi në lexim të tretë i Ligjit për OJQ nuk do të jetë vetëm votim i disa amandamenteve të propozuara nga shoqëria civile, por do të jetë tregues i qartë se në cilën anë qëndron secili deputet e parti politike, dhe përcaktues i të ardhmes së një sektori kyq të demokracisë së brishtë në Kosovë.

(Autori është pjesë e nismës së rreth 300 organizatave të shoqërisë civile në mbrojtje të parimit jo-për-përfitim në Ligjin për OJQ)